



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE PROCEDURALE LIGJORE DHE MARRËDHENIEVE ME JASHTË

Nr. 594 Prot.

Tiranë, më 18 / 06 / 2014

Lënda: Dërgohen rekomandime për ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008
“Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 74/2012

Drejtuar: Z. Ilir META
KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË

Për dijeni: Znj. Lefteri LLESHI
KRYETARE E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Z. Nasip NAÇO
MINISTËR I DREJTËSISË

Z. Florian RAUNIG
KRYETAR I PREZENCËS SË OSBE NË SHQIPËRI

TIRANË

I nderuar Zoti Kryetar!

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në përmbushje të qëllimit të ligjit nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin dhe bazuar në kompetencën ligjore të parashikuara nga neni 32, pika 1, germa “ë”, të këtij ligji, ku thuhet se: “Komisioneri ka kompetencë t’u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues”, rekomandon disa ndryshime në ligjin 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, (ndryshuar me ligjin nr.74/2012), si më poshtë:

1. Neni 9, i ligjit nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ndalon diskriminimin në ushtrimin e së drejtës për të zgjedhur, për t’u zgjedhur dhe për t’u emëruar në një detyrë publike, për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji.



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

Në nenin 3, ku parashikohen parimet e përgjithshme që udhëheqin Kodin Zgjedhor, në pikën 3 konstatojmë se gjen pasqyrim parimi i mosdiskriminimit, duke renditur një listë të kufizuar të shkaqeve të gjithë-njohura diskriminuese. Sa më sipër, rekomandojmë riformulimin e nenit 3, pika 3 të Kodit Zgjedhor, ku shkaqet e mbrojtura nga diskriminimi duhet të jenë në harmoni me parashikimet e nenit 1, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si më poshtë:

“Çdo shtetas shqiptar, që ka mbushur moshën 18 vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, pa dallim gjinie, race, ngjyre, etnie, gjuhe, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindje politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënie, përkatësie prindërore, përgjegjësie prindërore, moshe, gjendje familjare ose martesore, gjendje civile, vendbanimi, gjendje shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësie të kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër, ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet, në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë Kod”.

2. Në bazë të nenit 32, germa “dh”, Komisioneri ka kompetencë që të monitorojë zbatimin e këtij ligji, e për rrjedhojë edhe respektimin e zbatimit të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit të personave në të drejtën për të zgjedhur me për t’u zgjedhur. Për këtë arsye pasja nga ana e Komisionerit e të drejtës për të caktuar vëzhgues gjatë procesit zgjedhor është e domosdoshme për ushtrimin e kompetencave të këtij institucioni.

Në Kodin Zgjedhor e drejta për të caktuar vëzhgues gjen rregullim në nenin 6 të Kodit. Nga përmbajtja e kësaj dispozite nuk rezulton që institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi të jetë pjesë e subjekteve që kanë të drejtë për të caktuar vëzhgues. Sa më sipër rekomandojmë që në pikën 2, të nenit 6 të Kodit Zgjedhor të shtohet si institucion që ka të drejtën për të caktuar vëzhgues edhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

3. Neni 67, Lista e kandidatëve të partive dhe koalicioneve të partive, në pikën 6 vendos kushtin se “për çdo zonë zgjedhore, të paktën tridhjetë për qind e listës shumëmemërore dhe një në tre emrat e parë të listës shumëmemërore duhet t’i përkasë secilës gjini. (...)”.

Megjithë angazhimin për vendosjen e kuotës gjinore, sipas parashikimeve në nenin 67/6 të Kodit Zgjedhor, aktualisht në Kuvend gratë janë të përfaqësuara në nivelin 20%¹, ndërkohë që gratë përbëjnë 49 % të popullsisë.² Pavarësisht respektimit të këtyre dy kushteve në listat

¹ Marrë nga http://www.parlament.al/web/Deputetet_sipas_qarqeve_10029_1.php , Lista e deputetëve sipas qarqeve, me datë 17.01.2014.

² Sipas Census 2011, Popullsia banuese gjithsej e numëruar është 2 821 977, nga ku: Meshkuj 1 403 059 dhe Femra 1 397 079.



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

shumë-emërore nga subjektet zgjedhore, në praktikë një parashikim i tillë tregon se ka një boshllëk ligjor.

Neni 7 i Konventës së OKB-së “Mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Gruas”, e ratifikuar nga Kuvendi i R.Sh në vitin 1994, parashikon se: *“Shtetet palë do të marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në jetën politike dhe publike të vendit dhe në mënyrë të veçantë do t’u sigurojnë grave, në të njëjtat kushte me burrat, të drejtën: a. Për të votuar në të gjitha zgjedhjet dhe referendumet publike si dhe për të garantuar mundësinë që të zgjidhen në të gjitha organet e zgjedhura publike”.*

Në nenin 4, pika 5 të ligjit nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, parashikohet se: *“Përfaqësim i barabartë gjinor është përfaqësimi i secilës prej gjinive me jo më pak se 30 për qind në një institucion, në nivel drejtues, organ të emëruar, parti politike”.*

Ndërsa në nenin 15, të ligjit nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, parashikohet se: “Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor dhe në institucionet e tjera publike arrihet kur: a) sigurohet përfaqësim në masën mbi 30 për qind për secilën gjini, përfshirë edhe në organet e tyre drejtuese; b) sigurohet respektimi në mënyrë të njëjtë për secilën gjini i procedurave dhe kritereve të konkurrimit, gjatë emërimit në këto organe; c) sigurohet përfshirja mbi 30 për qind e secilës gjini në listën e kandidatëve për zgjedhjet në organet përfaqësuese vendore; ç) sigurohet përfshirja jo më pak se 30 për qind e secilës gjini në listën e kandidatëve të paraqitur nga partitë politike për sistemin proporcional për zgjedhjet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë; d) sigurohet përfshirja mbi 30 për qind të secilës gjini në organet administruese të procesit të zgjedhjeve qendrore dhe vendore”.

Gjithashtu, në përputhje me nenin 11 të Ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku parashikohet se *“Masa e përkohshme, e veçantë që synon përsheptimin e vendosjes reale të barazisë, kur mungesa e barazisë është shkaktuar nga diskriminimi për çdo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, konsiderohet veprim pozitiv dhe nuk përbën diskriminim, sipas këtij ligji. Kjo masë ndërpritet sapo të jenë arritur objektivat e trajtimit dhe ofrimit të mundësive të barabarta”*, rekomandojmë që neni 67/6 i Kodit Zgjedhor të amendohet, si më poshtë: *“Për çdo zonë zgjedhore, të paktën tridhjetë për qind e listës shumëemërore dhe një në çdo tre emra të listës shumëemërore duhet t’i përkasë secilës gjini. Subjekti paraqitës i listës deklaroi vendet, sipas kuotës gjinore, me qëllim zbatimin e përjashtimit, sipas pikës 2 të nenit 164 të këtij Kodi”.*

Në nenin 175, Kodi Zgjedhor parashikon sanksione në lidhje me mosrespektimin e barazisë gjinore. Konkretisht, mosrespektimi i kushtit, të parashikuar në nenin 67/6, dënohet nga KQZ-



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

ja me gjobë me 1 000 000 lekë në rastin e zgjedhjeve për Kuvendin dhe 50 000 lekë në rastin e zgjedhjeve për organet e pushtetit vendor.

Kështu, me ndryshimet në ligjin nr. 74/2012 është rritur dhe diversifikuar masa e gjobës në kuadër të respektimit të parimeve të barazisë gjinore përmes mekanizmit të kuotës. Por, nga praktika e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të zhvilluara në datë 23 qershor 2013³, rezultoi sipas deklaratës për shtyp të zëdhënësës së KQZ-së datë 27.09.2013, se partitë politike edhe pse u gjobitën me vlera të konsiderueshme 4 000 000 (katër milion) leke dhe 6 000 000 (gjashtë milion) lekë, përsëri nuk është bërë e mundur respektimi i kuotës gjinore.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson se sanksionet në lidhje me barazinë gjinore, të cilat aplikohen në rast moszbatimi të detyrimeve të parashikuara në pikën 6 të nenit 67 të këtij Kodi, duhen rritur, me qëllim forcimin e zbatimit të masave pozitive nëpërmjet kuotës gjinore.

Gjithashtu, konstatojmë një diferencë të madhe në masën e gjobës në rastin e zgjedhjeve për Kuvendin në raport me zgjedhjet për organet e pushtetit vendor.

Në vlerësimin tonë, por edhe nga fakti se megjithë sanksionet e rritura, në zgjedhjet e fundit për Kuvendin e Shqipërisë, nuk u arrit të sigurohej respektimi i kuotës gjinore prej 30 % për të garantuar në këtë mënyrë përfaqësimin e barabartë gjinor në Kuvendin e Shqipërisë. Mënyra më efikase për të garantuar respektimin e kuotës gjinore nga ana e partive politike do të ishte që në mënyrë kumulativë, së bashku me gjobën për mosrespektim të kuotës gjinore të aplikohet si sanksion edhe refuzimi i listave. **Sa më sipër, rekomandojmë:**

- Të rritet masa e gjobës sipas nenit 175, paragrafi 1, si për zgjedhjet për Kuvendin ashtu dhe për organet e pushtetit vendor
- Të mbahet parasysh zvogëlimi i diferencës ndërmjet sanksioneve të parashikuara në rastin e zgjedhjeve për Kuvendin me sanksionin në rastin e zgjedhjeve për organet e pushtetit vendor.
- Të shtohet si sanksion kumulativ së bashku me gjobën edhe refuzimi i listave të partive, në rast se ato nuk janë në respektim të kuotës gjinore prej 30% ⁴

³http://www.cec.org.al/index.php?option=com_content&view=article&id=565%3Adeklarate-per-shtyp-27092013&catid=51%3Adeklarata-2010&Itemid=158&lang=en

⁴ Referuar Raportit Përfundimtar të Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR mbi Zgjedhjet Parlamentare të R.Sh. të datës 23 Qershor 2013, thuhet se: *“Consideration should be given to further promote women candidates. The existing provision allowing the CEC to reorder candidate lists could be enforced as well as considering other possible sanctions for non-compliance. The Electoral Code could also be amended to require more balanced and consistent positioning of women candidates throughout party lists”*, faqe 12



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

4. E drejta për të marrë informacion për fushatën zgjedhore duhet të garantohet mbi baza të barabarta për të gjithë individët. Garantimi i të drejtës së personave me aftësi të kufizuar për të marrë pjesë në jetën politike, nuk mund të realizohet në mënyrë efektive në qoftë se nuk garantohet aksesimi në informacion për zgjedhësit me aftësi të kufizuara. Konventa e OKB-së *“Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”* në nenin 29 parashikon detyrimin e shtetit për të siguruar pjesëmarrjen e plotë dhe efektive në jetën politike të personave me aftësi të kufizuara dhe gjithashtu në nenin 21, parashikon detyrimin e shtetit për të siguruar të gjithë informacionin e synuar për publikun e gjerë, për personat me aftësi të kufizuar në formate dhe teknologji të aksesueshme. Në pikën 2, të nenit 80, të Kodit Zgjedhor parashikohet se: *“Radiotelevizioni publik e pasqyron fushatën zgjedhore nëpërmjet lajmeve dhe programeve informative, në përputhje me parimet e paanshmërisë, plotësisë, vërtetësisë dhe pluralizmit të informacionit, të parashikuara në legjislacionin që rregullon fushën e mediave elektronike. Minutazhi falas që përfitojnë partitë politike, sipas pikës 1 të këtij neni, nuk mund të caktohet si pjesë e lajmeve dhe programeve informative”*. Për të garantuar pjesëmarrjen efektive në jetën politike dhe pa diskriminim të personave me aftësi të kufizuar, **rekomandojmë: në nenin 80, pika 2, pas fjalisë së parë të kësaj pike, të shtohet një fjali me këtë përmbajtje: “Radiotelevizioni publik e bën pasqyrimin e fushatës zgjedhore në formate dhe teknologji të aksesueshme/të përshtatshme për lloje të ndryshme të aftësisë së kufizuar”**.

5. Personat me aftësi të kufizuar për një kohë të gjatë janë parë më shumë si objekte se sa si subjekte të të drejtave, duke evidentuar dhe theksuar paaftësinë/të. Ndërkohë, qasja e re që ofron Konventa e OKB-së *“Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar”*, bazohet jo më në modelin e *“bamirësisë”*, por atë të të drejtave të njeriut, ku personat me aftësi të kufizuar, si të gjitha qeniet njerëzore, i zotërojnë të drejtat e tyre në mënyrë të pakushtëzuar.

Në qendër të vëmendjes nuk është paaftësia e mundshme, por kufijtë/barrierat që vendos shoqëria, duke penguar gëzimin e të drejtave. Barrierat janë të shumëllojshme, ku përveç barrierave fizike, barrierat e ndryshme shoqërore të bazuara në stereotipe, çojnë drejt përjashtimit të personave me aftësi të kufizuara dhe potencialisht mbështesin këtë përjashtim.

Në këtë drejtim, një rol të rëndësishëm në ndryshimin e perceptimit që shoqëria ka për personat me aftësi të kufizuar është edhe gjuha e përdorur. Gjuha ndikon fuqimisht në ndryshimin e perceptimit për personat me aftësi të kufizuar. Rritja e ndërgjegjësimin në këtë drejtim është një detyrim i menjëhershëm që duhet të përmbushin shtetet sipas Konventës *“Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar”*. Sa më sipër **rekomandojmë që: emërtimi i nenit 108 të Kodit Zgjedhor të ndryshohet nga “Zgjedhësit që nuk votojnë vet” në “Zgjedhësit me aftësi të kufizuar”**.



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

6. Në bazë të Konventës së OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”, shtetet, përfshirë këtu edhe shtetin shqiptar, kanë marrë përsipër që të respektojnë, të mbrojnë dhe të garantojnë që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjithë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Pra, detyrimet e shtetit nuk qëndrojnë vetëm në detyrimin për të respektuar dhe mbrojtur këto të drejta, por shteti ka detyrimin që të marrë të gjitha masat e përshtatshme dhe të duhura, qofshin këto legjislative, administrative, buxhetore, gjyqësore apo çdo veprim tjetër që është i nevojshëm për të garantuar realizimin e plotë të këtyre të drejtave. Ndryshe nga të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore, të cilat shtetet kanë detyrimin që ti respektojnë dhe mbrojnë në mënyrë të menjëhershme, por t’i përmbushin apo realizojnë në mënyrë progresive, të drejtat politike, janë të drejta që shtete kanë detyrimin për t’i realizuar në mënyrë të menjëhershme.

Aktualisht, ashtu siç trajtohet edhe më sipër, ka parashikime ligjore për të garantuar votimin e personave me aftësi të kufizuara, por nga përmbajtja e këtyre parashikimeve për personat me aftësi të kufizuar nuk rezulton që të jetë marrë asnjë masë për të mundësuar votimin për personat me aftësi të kufizuar që nuk dalin dot nga shtëpia. Nga praktika e zgjedhjeve të zhvilluara në të shkuarën ka rezultuar se shumë nga këta zgjedhës me aftësi të kufizuar nuk e kanë realizuar dot të drejtën e tyre për të zgjedhur.

Sa më sipër, rekomandojmë që me prioritet të gjendet një zgjidhje ligjore nëpërmjet rregullimeve konkrete në Kodin Zgjedhor për të garantuar të drejtën e votës për zgjedhësit që nuk dalin dot nga shtëpia për të qenë prezent në qendrat e votimit.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,



Konc. Blerina Pirani
Klodiana Kamberaj



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al